



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.21 datë 01.08.2023

PËR

**KORIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL, KORRIGJIMIN E NIPT-it
NË LEJEN ME NR. SERIAL 000093 “PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR”, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC “SHUTRI 1
DHE SHUTRI 2” DHËNË ME VENDIMIN NR.13 DATË
28.03.2023, DUKE SHFRYTËZUAR UJIN E RRJEDHËS SË
PËRROIT TË SHUTRISË DHE UJIN E BURIMIT TË
SHUTRISË, BASENI UJOR MAT ME VENDNDODHJE, NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE RUKAJ TË BASHKISË
MAT, OARKU DIBËR, SUBJEKTIT “ATEANI ENERGY” SH.P.K”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” 1. Organi publik, në cdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të cdo kopje të njëhësuar të tij. Në këto kushte: pasi u konstatua gabimi dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e NIPT-it në “leje për përdorim burimi uJOR për prodhim hidroenergjie dhënë me vendimin nr.13 datë 28.03.2023, subjekti “ATEANI ENERGY”SII.P.K nga L72011006K të bëhet L78305901P
2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material (Nga NIPT-i L72011006K të bëhet L78305901P“
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbytjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

